



**PROGRAMI I ZHVILLIMIT PROFESIONAL
PËR MARRJEN E SHKALLËVE TË KUALIFIKIMIT TË MËSUESVE
TË ARSIMIT SPECIAL
2022**

1. HYRJE

Aftësia e mësuesve për ta bërë arsimimin e nxënësve, “preokupimin” kryesor të ditës, kërkon përkushtim, përgjegjshmëri dhe standarde të larta në punë dhe në sjellje. Mësuesit veprojnë me ndershmëri dhe integritet, kanë njohuri të forta shkencore, përdorin dijet dhe aftësitë e tyre, por në të njëjtën kohë përditësojnë njohuritë nëpërmjet vetëvlerësimeve të vazhdueshme, krijojnë marrëdhënie pozitive profesionale dhe punojnë me prindërit në interesin më të mirë të nxënësve të tyre.

Programi i zhvillimit profesional për marrjen e kategorive të kualifikimit të mësuesve të arsimit special, është hartuar nga grupi i punës, i ngritur nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP), për t’u ardhur në ndihmë të gjithë mësuesve të arsimit special në përgatitjen për testimin kombëtar, për marrjen e kategorive të kualifikimit, si dhe të gjitha Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar dhe Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar, për të organizuar zhvillimin profesional për të gjithë mësuesit që do të hyjnë në këtë proces.

Programi është hartuar në përgjigje të kërkesave që MAS-i ka vendosur për mësuesit që kualifikohen. Programi është hartuar duke mbajtur parasysh se fushat kryesore në të cilat testohen njohuritë dhe aftësitë e mësuesve janë:

- dokumentacioni zyrtar¹ shkollor, i cili ka të bëjë me veprimtarinë mësimdhënëse dhe edukative të mësuesve në shkollë;
- programet përkatëse lëndore;
- aspekte të pedagogjisë, metodologjisë dhe përdorimit të TIK-ut në mësimdhënie-nxënie, në përgjithësi dhe të arsimit special, në veçanti;
- aspekte të etikës dhe të komunikimit;
- aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe;
- përmbajtja shkencore e lëndëve sipas programeve lëndore përkatëse.

¹Dokumentet ligjore, urdhëresat dhe udhëzimet e MAS-it që zbatohen në shkollë duke u përqendruar në ato të viteve të fundit.

2. QËLLIMI I PROGRAMIT

Qëllimi i hartimit të programit të zhvillimit profesional të mësuesve për efekt kualifikimi është:

- të ofrojë një program orientues për t'u ardhur në ndihmë të gjithë mësuesve të arsimit special në arsimin parauniversitar, për të realizuar veprimtaritë kualifikuese dhe trajnuese, si dhe DRAP-eve, ZVAP-ve, për të organizuar zhvillimin profesional të mësuesve. Në këtë aspekt, programi mund të plotësohet nga DRAP-et, ZVAP-të përkatëse, sipas kushteve dhe mundësive konkrete;
- të ofrojë një program të detyruar, për mësuesit që këtë vit do të marrin kategoritë e kualifikimit, në mënyrë që ata të realizojnë një përgatitje, për të përballuar me sukses kërkesat që ka testimi kombëtar.

Nëpërmjet programit të kualifikimit, mësuesi përgatitet për testim. Ai:

- njeh dhe zbaton legjislacionin arsimor e në mënyrë të veçantë risitë më të fundit të reformës arsimore;
- zotëron kompetencat, bazuar në standardet profesionale të mësuesit, për të ndikuar drejtpërdrejt në efektivitetin e procesit mësimor, për një mësimdhënie të suksesshme;
- demonstroi aftësitë në fushën pedagogjike për përzgjedhjen e modeleve për organizimin e klasës, për shtjellimin e koncepteve, për nxitjen e diskutimeve, për përdorimin e teknikave të vlerësimit të nxënësve etj.;
- tregon përgjegjshmëri në njohjen e koncepteve bazë si dhe të zbatimit të tyre në praktikë, në përputhje me specifikat e moshës së nxënësve dhe të klasës ku japin mësim;
- njeh konceptin e gjithë përfshirjes dhe demonstroi përfshirjen e nxënësve në procesin mësimor dhe në aktivitetet e shkollës;
- demonstroi zbatimin e rregullave të etikës dhe komunikimit në punën e tij në shkollë;
- zotëron zbatimin e rregullave drejtshkrimore të gjuhës shqipe gjatë procesit të mësimdhënie - nxënies;

3. PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

Programi është strukturuar sipas fushave kryesore të zhvillimit profesional, të përmendura më sipër. Për të qenë lehtësisht i përdorshëm, programi është paraqitur sipas një formati të caktuar.

Për secilën fushë, përcaktohen:

- kompetencat profesionale, si dhe rezultatet e pritshme për realizimin e këtyre kompetencave;

- literatura përkatëse rekomanduese në funksion të përvetësimit të kompetencave të fushës/lëndës.

Përshkallëzimi i njohurive dhe i aftësive profesionale, të cilat lidhen me kompetencat e secilës fushë/lëndë të testimit, do ta ndihmojë mësuesin që të identifikojë çështjet në të cilat duhet të përqendrohet.

| FUSHA: DOKUMENTE ZYRTARE | |
|---|--|
| Kompetenca | Literatura e rekomanduar |
| Zbatimi me përgjegjshmëri i kërkesave të legjislacionit dhe dokumentacionit shkollor | |
| <p><i>Mësuesi i arsimit special:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • zotëron Ligjin për sistemin arsimor parauniversitar dhe Rregulloren për funksionimin e Institucioneve Arsimore Parauniversitare në Republikën e Shqipërisë. • zbaton legjislacionin, udhëzimet dhe rregulloret për hartimin dhe zbatimin e kurrikulës shkollore; • zbaton legjislacionin, udhëzimet dhe rregulloret për personelin e shkollës; • demonstroi zbatimin konkret të udhëzimeve të MASR-së në funksion të përmirësimit të procesit të mësimdhënie-nxënies; • zbaton etikën profesionale të mësuesit; • respekton të drejtat dhe liritë e nxënësit; • respekton detyrat, të drejtat dhe liritë e mësuesit; • zbaton rregulloret dhe udhëzimet për zhvillimin profesional të mësuesit. | <ul style="list-style-type: none"> • Ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar • Rregullore e funksionimit të institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë, miratuar me Urdhër nr.31, datë 28.01.2020 • Udhëzimi nr.17 “Për fillimin e vitit shkollor 2021-2022 në sistemin arsimor parauniversitar”, MAS (16.08 2021). • Rregullore e funksionimit të institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë, miratuar me Urdhër nr.31, datë 28.01.2020 • Udhëzimi nr. 30, datë 12.09.2018 “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar”, ndryshuar me Udhëzim nr.14, date 28.7.2021 • Udhëzimi nr. 16, datë 28.07.2021 “Për organizimin dhe funksionimin e sistemit të |

| | |
|--|--|
| | <p>zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë”</p> <ul style="list-style-type: none"> • Udhëzimi nr. 4, datë 26.02.2021. “Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të mësuesve”. • Udhëzimi nr.34, datë 11.09.2015 “Për vlerësimin e nxënësve për kurrikulën me kompetenca, në arsimin bazë” • Urdhri Nr.6, datë 10.01.2018 për zbatimin e nismës “Tri lëndë në gjashtë orë” • Urdhër nr.46 datë 24.07.2020 “Për standardet profesionale të formimit të përgjithshëm dhe të formimit lëndor të mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar” |
|--|--|

FUSHA: PROGRAME LËNDORE

| Kompetenca | Literatura e rekomanduar |
|--|---|
| <p style="text-align: center;">Zbatimi në mënyrë efektive i programeve të arsimit special në shkollë</p> | |
| <p><i>Mësuesi i arsimit special:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • zbaton programin duke respektuar të gjitha kërkesat dhe rubrikat e tij; • përshtat programet lëndore të arsimit fillor në përputhje me veçoritë e mjedisit në të cilin jep mësim; • përdor me efikasitet, në dobi të prirjeve bashkëkohore, fleksibilitetin e zbatimit të programit; • gjen ose harton materiale plotësuese kurrikulare që ndihmojnë në përvetësimin e koncepteve dhe aftësive të parashikuara në program; | <ul style="list-style-type: none"> • Korniza Kurrikulare 2014 • Kurrikula bërthamë AMU, klasat 6-9, 2014 • Programet aktuale lëndore të arsimit fillor • Literaturë që ka në fokus sindroma të ndryshme si autizëm, DOWN, prapambetje mendore, çrregullime të sjelljes, hiperaktivitet etj. |

| | |
|---|--|
| <ul style="list-style-type: none"> • harton plane edukative individuale (PEI) në përgjigje të aftësive dhe nevojave specifike të fëmijës; • harton rezultate të nxëni për tema mësimore ose grup temash, kapitujsh, në përputhje me objektivat e programit (PEI); • harton rezultate të nxëni specifike që u përgjigjen niveleve të ndryshme të nxënësve; • tregon koherencën vertikale të kurrikulës (vazhdimësia dhe përshtatshmëria e programeve të arsimit special); • përzgjedh mjete mësimore të personalizuara, të nevojshme për të realizuar përmbushjen e PEI-it. | |
|---|--|

FUSHA: ASPEKTE TË PEDAGOGJISË, METODOLOGJISË DHE PËRDORIMIT TË TIK –ut NË MËSIMDHËNIE-NXËNIE

| <p style="text-align: center;">Kompetenca I</p> <p style="text-align: center;">Zotërimi i njohurive pedagogjike specifike të nevojshme dhe të mjaftueshme për mësimdhënien në arsimin special</p> | <p style="text-align: center;">Literatura e rekomanduar</p> |
|---|---|
| <p><i>Mësuesi i arsimit special:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • demonstroi përkushtim, motivim dhe përgjegjësi gjatë punës së tij; • përshtat punën e tij me zhvillimin fizik, social, emocional dhe konjitiv të nxënësve; • demonstroi respekt, besim dhe objektivitet me nxënësit; • identifikoi nevojat specifike të nxënësve; | <ul style="list-style-type: none"> • Korniza e vlerësimit të nxënësit, MAS, 23.07.2015 • Udhëzuesi i zhvillimit të kurrikulës në arsimin e mesëm të ulët, 2017 • Vlerësimi i nxënësit në arsimin e mesëm të ulët dhe në arsimin e mesëm të lartë (<i>Material shpjegues në ndihmë të shkollave</i>), nëntor 2018 • Literaturë që ka në fokus sindroma të ndryshme si autizëm, DOWN, |

| | |
|---|---|
| <ul style="list-style-type: none"> • planifikon punën afatshkurtër dhe afatgjatë me secilin nxënës; • demonstroi qëndrim pozitiv ndaj procesit të të nxënës; • motivon nxënësit duke e konsideruar motivimin një nga çelësat e progresit të tyre; • krijon klimë të përshtatshme, motivuese dhe të kënaqshme për nxënësit; • punon me prindërit për përmirësimin e progresit të nxënësit. | <p>prapambetje mendore, çrregullime të sjelljes, hiperaktivitet etj.</p> |
| <p>Kompetenca II</p> <p>Përdorimi i metodave dhe strategjive efektive në mësimdhënien në arsimin special</p> | <p>Literatura e rekomanduar</p> |
| <p><i>Mësuesi i arsimit special:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • përdor metoda të ndryshme në përputhje me sindromën që shfaqin fëmijët me aftësi të kufizuara; • përzgjedh metodat dhe teknikat e përshtatshme për arritjen e një objekti të caktuar; • përdor metoda e teknika që i aftësojnë nxënësit në jetën e përditshme; • respekton parimet bazë të edukimit special; • planifikon një orë mësimore duke u bazuar në mësimdhënien me në qendër nxënësin; • përdor metoda e teknika që sigurojnë barazinë dhe gjithë përfshirjen; | <ul style="list-style-type: none"> • Udhëzuesi i zhvillimit të kurrikulës në arsimin e mesëm të ulët, 2017 • Nivelet e arritjes (arsimi bazë), IZHA 2016 • Vlerësimi i nxënësit në arsimin e mesëm të ulët dhe në arsimin e mesëm të lartë (<i>Material shpjegues në ndihmë të shkollave</i>), Shtator 2019 • Literaturë që ka në fokus aspekte të mësimdhënies dhe nxënies me nxënësit me sindromë të ndryshme si autizëm, DOWN, prapambetje mendore, çrregullime të sjelljes, hiperaktivitet etj. |

| | |
|---|--|
| <ul style="list-style-type: none"> demonstron teknika të ndryshme për vlerësimin e nxënësit; harton fisha për vlerësimin e nxënësit sipas fushave të zhvillimit; përdor programe kompjuterike në ndihmë të realizimit të objektivave mësimorë. | |
|---|--|

FUSHA: ASPEKTE TË ETIKËS DHE TË KOMUNIKIMIT

| Zbatimi i rregullave të etikës dhe komunikimit si elemente të domosdoshme në të gjithë punën e mësuesit | Literatura |
|---|---|
| <p><i>Mësuesi i arsimit special:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> njuh rregullat e etikës dhe sjelljes që duhen respektuar në marrëdhënie me drejtuesit e institucionit arsimor, stafin pedagogjik, nxënësit, prindërit dhe komunitetin; sillet në përputhje me rregullat e etikës dhe të sjelljes në marrëdhënie me drejtuesit, stafin pedagogjik, nxënësit, prindërit dhe komunitetin gjatë punës së tij brenda dhe jashtë institucionit arsimor. | <ul style="list-style-type: none"> Kodi i Etikës së mësuesve në arsimin parauniversitar Urdhër nr.46 datë 24.07.2020 “Për standardet profesionale të formimit të përgjithshëm dhe të formimit lëndor të mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar” Literaturë dhe materiale burimore që trajtojnë çështje të etikës dhe të komunikimit. |

FUSHA: ASPEKTE TË DREJTSHKRIMIT TË GJUHËS SHQIPE

| Zbatimi i rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe | Literatura |
|---|--|
| <p><i>Mësuesi i arsimit special:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> njuh rregullat e drejtshkrimit të standardit të gjuhës shqipe; demonstron zbatimin e rregullave të drejtshkrimit gjatë veprimtarive në institucionin arsimor. | <ul style="list-style-type: none"> Drejtshkrimi i gjuhës shqipe |

FUSHA: PËRMBAJTJA SHKENCORE E LËNDËS

| Kompetenca Respektimi i rigorozitetit shkencor në mësimdhënien në arsimin special | Literatura e rekomanduar |
|---|---|
| <p><i>Mësuesi i arsimit special:</i></p> <ul style="list-style-type: none">• shpjegon konceptet kryesore me të cilat operon mësimi në arsimin special;• demonstroi veprimtari me nxënësit me qëllim aftësimin e tyre në lidhje me veprimtaritë e jetës së përditshme;• shpjegon dhe interpreton parimet dhe konceptet në lidhje me zhvillimin e tyre në fushën konjitive, sociale, motorike, të komunikimit dhe autonomisë personale;• tregon përmes shembujve përshkallëzimin e veprimtarive për të arritur përvetësimin nga nxënësit të koncepteve dhe shprehive;• përdor veprimtari të ndryshme në përputhje me sindromën që shfaqin fëmijët me aftësi të kufizuara. | <ul style="list-style-type: none">• Literaturë që ka në fokus njohuri dhe informacion rreth sindromave të ndryshme si autizëm, DOWN, prapambetjen mendore, çrregullime të sjelljes, hiperaktivitet etj.• Literaturë që ofron informacion dhe shembuj konkretë të punës me fëmijët me sindromë të ndryshme si autizëm, DOWN, prapambetje mendore etj. |